



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 81, datë 02.03.2022**

**PËR**

**PËRSËRITJEN E KOMANDIMIT TË GJYQTARES ZNJ. {...}  
NË POZICIONIN E NËPUNËSIT PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN NË NJËSINË E  
VLERËSIMIT PROFESIONAL DHE ETIK TË GJYQTARËVE NË KËSHILLIN E  
LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54 dhe 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 104, datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, pasi shqyrtoi kërkesën e znj. {...}, protokolluar në Këshill me aktin nr. 1120, datë 22.02.2022, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dy vjeçar.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 02.03.2022.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**